

VENDIM
Nr.275, datë 25.6.1992

**PËR RREGULLAT E ADMINISTRIMIT DHE TË KONTROLLIT TË ARMËVE PËR
PERSONAT FIZIKË E JURIDIKË**

Për të pasur rregullsi në administrimin dhe kontrollin e armëve të personave fizikë e juridikë, në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për administrimin e bazës materialo-teknike të armëve të zjarrit luftarake, sportive, të gjahut dhe të municioneve të tyre mbahet llogari dokumentare në organe e reparte e në aparatin qëndror, që plotësohen sipas udhëzuesit metodik të ministrit të Rendit Publik.

2. Humbja e armatimit është ngjarje e jashtëzakonshme dhe për këtë njoftohen menjëherë organet e hetuesisë, degët e rendit publik dhe Ministria e Rendit Publik; ato mbahen në evidencë si armë të humbura dhe shkarkohen nga llogaria.

3. Organet e Rendit Publik pajisin me armë zjarri organike gjithë personat e parashikuar në nenin 5 dhe me armë zjarri personat e parashikuar në nenin 7 të ligjit "Për armët".

4. Në degët e rendit publik funksionon komisioni i dhënies dhe i heqjes së armëve për personat e parashikuar në nenin 7 të ligjit "Për armët", si dhe për ata që kërkojnë të pajisen me armë gjahu.

5. Armët e zjarrit luftarake, sportive, të gjuetisë dhe të ftohta mbahen vetëm me lejen e organeve të rendit publik. Leja e armës është dokument zyrtar që i shërben shtetasit për të vërtetuar se ka të drejtë të mbajë vetëm armën e shënuar në të.

6. Ndërmarrjet dhe institucionet që do të kërkojnë për të pajisur rojet e tyre me armë zjarri luftarake të gjatë, si dhe personat që kërkojnë të pajisen me armë gjahu, duhet më parë t'i bëjnë kërkesë me shkrim degës së rendit publik.

7. Armët e zjarrit luftarake që mbahen me leje, duhet të ruhen mirë, që të mos bien në dorë të personave të tjerë. Ato përdoren vetëm për atë qëllim që janë dhënë dhe në përputhje me ligjin "Për armët".

8. Kur shtetasi i pajisur me armë zjarri luftarake, për shkak të detyrës ose për arsye shërbimi largohet nga kjo detyrë, ose ikën jashtë shtetit, ose vdes, arrestohet, humb aftësitë për mbajtjen e saj, detyrohet (ai ose familja e tij) që armën dhe municionin përkatës ta dorëzojë brenda 3 ditëve në degën e rendit publik të rrethit. Gjithashtu arma dorëzohet edhe kur shtetasi largohet me banim të përhershëm nga rrethi që ia ka dhënë lejen.

9. Armët e zjarrit dhe municionet e tyre, me të cilat pajisen muzetë, si dhe ato që kanë në përdorim trupat e teatrove, lejohet të mbahen pasi të jenë bërë të paefektshme dhe me leje në formë liste, ku shënohet lloji i armëve dhe numrat e tyre.

10. Armët e zjarrit, me të cilat pajiset Kinostudioja "Albafilm", administrohen sipas rregullave të veçanta të caktuara nga Ministria e Rendit Publik.

11. Leja për armët e zjarrit sportive u jepet vetëm në formë liste instruktorëve të caktuar nga seksioni i arsimit në organet e pushtetit lokal, kur ata plotësojnë kushtet e parashikuara në ligjin "Për armët" dhe vetëm kohën e stërvitjes me këto armë. Ato mbahen dhe përdoren vetëm gjatë kohës së stërvitjes në poligonet e caktuara.

12. Armët e zjarrit sportive ruhen dhe administrohen njëllëj si armët e zjarrit luftarake. Ruajtja dhe depozitimi i armëve të zjarrit sportive si gjatë ndërprerjes së përkohshme të stërvitjes, ashtu edhe pas saj, lejohet vetëm në depo të caktuara pranë poligoneve të qitjes. Ato duhet të jenë të siguruara në çdo kohë me roja të armatosura. Në çdo depo mbahet evidencë e rregullt për armët që ka.

Ndalohet rreptësisht mbajtja e armëve të zjarrit sportive në shtëpi, konvikte ose hotele, si dhe çfarëdo vendi tjetër, jashtë depove të caktuara për ruajtjen e tyre.

13. Ministria e Rinisë, Kulturës dhe e Sporteve ia dorëzon armët e zjarrit sportive dhe municionet e tyre Ministrisë së Rendit Publik, e cila i shpërndan ato nëpër degët e rendit publik të rretheve, sipas planit të Ministrisë së Rinisë, të Kulturës dhe të Sporteve.

14. Kontrolli për mbajtjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit luftarake e sportive, të mbajtura

nga shtetasit dhe instruktorët e stërvitjes ushtrohet nga gjithë punonjësit e organeve të rendit publik. Ata i heqin në vend shtetasit armën e zjarrit të çfarëdo lloji, kur:

- a) Kryen krimin e mbajtjes, të prodhimit, blerjes ose shitjes së armës pa leje.
- b) Ka përdorur ose paraqet rrezik të përdorë armën si mjet për të kryer vepër penale.
- c) Kryen kundërvajtje, duke shkelur dispozitat e ligjit "Për armët" dhe rregullat e caktuara në këtë vendim.

Heqja e armës në vend, përveç rasteve kur bëhet ndjekje penale, ka fuqi derisa komisioni të marrë vendim për heqjen ose jo të armës.

15. Të gjitha armët e zbuluara, të dorëzuara e të gjetura evidencohen në regjistrin përkatës, sipas modelit të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Rendit Publik.

Armët e zbuluara, të dorëzuara e të gjetura janë në dispozicion të Ministrisë së Rendit Publik.

16. Për inventarizimin dhe mbledhjen e armëve të zjarrit luftarake nga degët e rendit publik në rrethe të krijohen komisionet e posaçme në bazë zonash dhe, brenda muajit qershor 1992, të përfundojë inventarizimi dhe kontrolli i gjendjes teknike të armëve të dhëna me leje mbi bazën e kriterëve të ligjit. Ky veprim të kryhet çdo vit pasardhës, brenda tremujorit të parë.

17. Për shtetasit që u mungojnë armët dhe municionet e dhëna me leje, bëhet kallëzim për ndjekje penale.

18. Për shtetasit që pas mbarimit të afatit për inventarizimin e mbledhjen e armëve nuk i dorëzojnë ato, bëhet kallëzimi për ndjekje penale për armëmbajtje pa leje, në bazë të ligjit "Për armët".

19. Armët trofe që dorëzohen nga veteranët, duhet të regjistrohen në regjistër të veçantë dhe të magazinohen me gjithëemrin e dorëzuesit.

20. Ndalohet futja e çdo lloj arme nga jashtë, me përjashtim të armëve dhe municioneve të gjahut, për të cilat më parë të jetë dhënë leja e mbajtjes së armës nga organet e rendit publik.

21. Për shtetasit e huaj që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose ndodhen aty dhe disponojnë armë gjahu, jepet leje e përkohshme dhe evidencohen në një regjistër të posaçëm nga organet e rendit publik.

22. Për të kontrolluar gjendjen teknike të armëve të gjahut në rreth, çdo vit para hapjes së sezonit të gjuetisë krijohet komisioni i posaçëm, i përbërë nga përfaqësuesit e organeve pyjore, përfaqësuesi i shoqatës së gjuetarëve, degës së rendit publik dhe tekniku i armatimit të ushtrisë.

23. Ndreqja e armëve të gjahut dhe të ftohta lejohet vetëm në punishte të caktuara dhe të pajisura me leje nga organet e rendit publik. Në këto punishte ndreqen vetëm armët që mbahen me lejen e organeve të rendit. Armët në këto punishte duhet të sigurohen mirë në dollap metalik. Aty duhet të ketë një regjistër të veçantë, ku të shënohet pronari dhe arma e rregulluar.

24. Për të siguruar jetën dhe shëndetin e shtetasve, si dhe për të mënjанuar pasojat e tjera të dëmshme, ndalohet kategorikisht:

a) Qitja me armë gjahu dhe armë zjarri luftarake në raste festash, manifestimesh, fejesa, martesë e vdekje, si dhe në raste të tjera.

b) Qitja për qëllim gjuetie me armë gjahu ose armë zjarri luftarake, duke përdorur automjetet apo çdo lloj drite.

Shkeljet e mësipërme, kur nuk formojnë vepër penale, dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë deri në 1000 lekë dhe deri në marrjen e armës nga organet përkatëse dhe sipas procedurës së caktuar në ligjin "Për armët".

25. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Rendit Publik, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ Kombëtar.

26. Në zbatim të këtij vendimi ministri i Rendit Publik nxjerr udhëzimin përkatës.

27. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.212, datë 8.7.1991 "Për pajisjen me armë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi